

AKTIVITET 7

VIZITË NË BASHKINË E SHKODRËS, TAKIM ME DREJTORESHËN E PUNËVE SOCIALE DHE SHËNDETIT PUBLIK, ARLINDA BILALI

Në takim morën pjesë një grup nxënësish nga klasa e nëntë. Fokusi i diskutimit ishin:

- njohja e përvojës lokale,
- llojet e ndryshme të punëve,
- roli i bashkisë në ofrimin e shërbimeve,
- njohja me procedurat e punësimit,
- ofrimi i trajnimeve dhe aktiviteteve në zhvillimin e karrierës.

Nxënësit shprehën dëshirat e tyre, bënë pyetje (përpjekje për të ndryshuar diçka, në mënyrë që të mos largohen të rinjtë). Ata kërkuan që vëmendja të përqendrohet tek informimi më i madh nga ana e Bashkisë për aktivitetet, projektet, trajnimet, si dhe qendrat që i zhvillojnë këto veprimtari.



